



PROGRAMI I TALENTEVE RINORE

Udhëzues për të Rinjtë — Si të Aplikoni dhe Çfarë Duhet të Dini

THIRRJA VJETORE 2026

Çfarë është ky program?

Programi i Talenteve Rinore është një program shtetëror i cili zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR). Ai mbështet të rinjtë shqiptarë që përfaqësojnë vendin në kompeticione dhe veprimtari zyrtare ndërkombëtare në fushat e artit, kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit.

Programi i Talenteve Rinore është një nga instrumentet kyçe të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022–2029. Kjo strategji ka si mision fuqizimin, mbështetjen dhe aktivizimin e të rinjve, duke krijuar kushte reale për zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, pavarësisht prejardhjes sociale apo mundësive ekonomike. Programi i Talenteve Rinore e mishëron këtë vizion duke u fokusuar pikërisht tek ata të rinj që kanë talentin, por nuk kanë gjithmonë mjetet financiare për ta shfaqur atë në arenën ndërkombëtare.

Agjencia Kombëtare e Rinisë ka një buxhet vjetor prej 20.000.000 ALL për zbatimin e Programit të Talenteve Rinore, i cili ofron dy lloje mbështetjeje:

- kompensim të shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit para veprimtarisë, dhe
- shpërblim financiar pas arritjes së rezultatit.

Ky udhëzues është hartuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.120, datë 27.02.2026 "*Për miratimin e rregullave për organizimin, kriteret, mënyrën e mbështetjes dhe masën e shpërblimit financiar për të rinjtë në Programin e Talenteve Rinore*" me qëllim lehtësimin e përfitimit të të rinjve nga ky program. Dokumenti paraqet në mënyrë të thjeshtë dhe të strukturuar të gjitha hapat që duhet të ndjekë një kandidat nga verifikimi i kushteve të kualifikimit dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm deri tek vlerësimi i aplikimit nga Komisioni i Vlerësimit, nënshkrimi i marrëveshjes me AKR-në, disbursimi i mbështetjes financiare dhe në fund, dorëzimi i dokumenteve justifikuese të shpenzimeve. Udhëzuesit i bashkëngjiten, disa lidhje/tabela që tregojnë mënyrën e llogaritjes së mbështetjes financiare. Udhëzuesi synon të jetë mjeti kryesor orientues për çdo të ri shqiptar që dëshiron të përfitojë nga ky program, duke siguruar transparencë të plotë mbi të drejtat, detyrimet dhe afatet që rregullojnë marrëdhënien midis kandidatit dhe institucionit.

PERSE U KRIJUA KY PROGRAM?

Programi i Talenteve Rinore mbështetet në dy shtylla ligjore kryesore. Së pari, Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë" i ndryshuar, i cili në Nenin 16/1 autorizon Këshillin e Ministrave të miratojë rregullat e hollësishme për organizimin, kriteret, mënyrën e mbështetjes dhe masën e shpërblimit financiar për të rinjtë e talentuar. Ky ligj përcakton se mbështetja e talenteve rinore është detyrim institucional i shtetit shqiptar, jo thjesht nismë vullnetare.

Mbi këtë bazë, është miratuar VKM-ja Nr.120, datë 27.02.2026 "Për miratimin e rregullave për organizimin, kriteret, mënyrën e mbështetjes dhe masën e shpërblimit financiar për të rinjtë në Programin e Talenteve Rinore". Kjo VKM është akti nënligjor që rregullon çdo aspekt teknik dhe praktik të programit: kush mund të aplikojë, si vlerësohet aplikimi, sa mbështetje financiare jepet dhe në çfarë mënyre.

Qëllimet e Programit

- Identifikimi dhe mbështetja e të rinjve me talente të spikatura në fushat e artit, kulturës, edukimit, shkencës, teknologjisë dhe sportit.
- Financimi i pjesëmarrjes së tyre në kompeticione dhe veprimtari zyrtare ndërkombëtare, duke nxitur kultivimin e talentit përmes garës me bashkëmoshatarë nga e gjithë bota.
- Shpërblimi i rezultateve të larta si akt vlerësimi dhe si model frymëzimi për brezin e ri.
- Garantimi i barazisë së mundësive: të rinjtë nga familje të disavantazuara ekonomikisht ose nga grupe të cënueshme kanë akses të njëjtë dhe mbështetje shtesë krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre.
- Rritja e pjesëmarrjes cilësore të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare nëpërmjet rezultateve të talenteve rinore.

Nëse ke punuar dhe studiuar fort, ke konkurruar, ke përfaqësuar shkollën, klubin apo vendin tënd dhe tani ke mundësinë të dalësh në arenën ndërkombëtare, kostot nuk do të jenë më pengesë falë Programit të Talenteve Rinore. Nuk ka rëndësi nga cili qytet je, nga vjen, apo nëse është hera e parë që merr pjesë në një konkurs/veprimtari ndërkombëtare, nëse ke arritur të përzgjidhesh për të përfaqësuar Shqipërinë, ke mundësi të aplikosh pranë AKR-së për të marrë mbështetje financiare.

Lexo hapat që vijojnë, kontrollo nëse plotëson kriteret.

HAPI 1 — A KUALIFIKOHESH?

Programi i Talenteve Rinore mbështet pjesëmarrjen e të rinjve në një gamë të gjerë veprimtarish ndërkombëtare.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

- Kandidati i përket grup-moshës 15-29 vjeç
- Kandidati është shtetas shqiptar.
- Kandidati është përzgjedhur për të përfaqësuar vendin në veprimtarinë ndërkombëtare në fushën e arsimit, në bazë të konkurrimit në nivel kombëtar, të organizuar apo të njohur nga Ministria e Arsimit.
- Kandidati është përzgjedhur për të përfaqësuar vendin në një veprimtari ndërkombëtare të sportit individual, në bazë të konkurrimit në nivel kombëtar, të organizuar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar ose nga një federatë sportive shqiptare;
- Kandidati është përzgjedhur për të marrë pjesë në një veprimtari ndërkombëtare në fushën e artit, të kulturës, të edukimit, të shkencës e të teknologjisë të organizuar nga:
 - një organizatë ndërqeveritare;
 - një qeveri e njohur ndërkombëtarisht;
 - një nga 100 (njëqind) universitetet më të mira në botë, sipas fushës specifike të edukimit që përkon me fushën e veprimtarisë ndërkombëtare nga “Times Higher Education” – renditja botërore e universiteteve;
 - një nga 500 (pesëqind) ndërmarrjet më të mëdha në botë, sipas renditjes botërore “Fortune 500”, për vitin e aplikimit;
 - rrjetet panevropiane të organizatave kulturore dhe krijuese, mbështetur nga Programi i Evropës Krijuese i Bashkimit Evropian.
- Kandidati është përzgjedhur si delegat zyrtar rinor ose nga programe të ngjashme përfaqësimi për të rinjtë të ngritura nga organizatat ndërqeveritare¹;
- Kandidati është përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë ose trashëgiminë e saj kulturore, arsimore, shkencore, teknologjike apo sportive në veprimtarinë e organizuar një vend tjetër të konfirmuar nga misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë në vendin përkatës.

CILAT FUSHA MBËSHTETEN?

Kujdes!! Në varësi të fushave që mbështeten kontrollo nëse plotëson kriteret:

Arsimi

✓ Je përzgjedhur nga Ministria e Arsimit për të përfaqësuar Shqipërinë.

✓ Ke konkurruar në nivel kombëtar dhe je zgjedhur fitues/perfaqësues zyrtar në një aktivitet ndërkombëtar që njihet nga Ministria e Arsimit.

Sporti

✓ Je përzgjedhur nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar ose një federatë sportive shqiptare.

¹ Organizatat ndërqeveritare konsiderohen organizatat e përbëra nga shtetet të krijuara me marrëveshje ndërkombëtare, që veprojnë sipas së drejtës ndërkombëtare dhe ndjekin qëllime të përbashkëta të shteteve anëtare.

Arti, Kultura, Shkenca, Teknologjia, Edukimi

✓ Organizatori është organizatë ndërqeveritare² (OKB, UNESCO, BE, NATO, FMN, Banka Botërore etj.)

✓ Organizatori është qeveria e njohur ndërkombëtarisht e një shteti.

✓ Organizatori është një nga 100 universitetet më të mira (Times Higher Education).

✓ Organizatori është një nga 500 kompanitë Fortune 500.

✓ Organizatori është rrjet pan-europian i mbështetur nga Programi i Evropës Krijuese.

Aktivite të tjera

✓ Je delegat rinor zyrtar **i pajisur me mandat përfaqësimi.**

✓ Je përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë ose trashëgiminë e saj jashtë vendit konfirmuar nga misioni diplomatik shqiptar

Kategori me Përparësi — Trajtohen me Prioritet

Nëse i përket njërit prej grupeve të mëposhtme, aplikimi yt shqyrtohet me përparësi dhe ke të drejtë mbështetje shtesë:

- Ke statusin jetim;
- Ke humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;
- Je person me aftësi të kufizuara;
- Je person që ka statusin “viktimë trafikimi”/“viktimë e mundshme trafikimi”³;
- I përket pakicës kombëtare romë dhe egjiptiane;
- Gëzon statusin e “Fëmijës në përkujdesjen e Republikës”;
- I përket një familjeje në skemën e ndihmës ekonomike;
- Je fëmijë i vendosur në shërbimin e kujdestarisë së përkohshme.

Kujdes!! Duhet të dorëzoni së bashku me dokumentet e tjera të aplikimit, dokumentin që vërteton se cilit prej grupeve të mësipërme i përkisni.

⚠ Mbështetje Shtesë për Grupet/Kategoritë me Prioritet

Nëse i përket këtyre kategorive ke gjithashtu të drejtë mbështetje financiare shtesë prej 10% të vlerës së akomodimit për shpenzime si: viza, regjistrimi, sigurim shëndetësor, transport i brendshëm, ushqim — me kusht që këto kosto nuk mbulohen nga organizatori.

² Organizatat ndërqeveritare konsiderohen organizatat e përbëra nga shtetet të krijuara me marrëveshje ndërkombëtare, që veprojnë sipas së drejtës ndërkombëtare dhe ndjekin qëllime të përbashkëta të shteteve anëtare.

³ AKR merr përsipër se do të ruajë konfidencialitetin e personave që i përkasin këtij grupi.

Cfarë dhe SA MBËSHTETJE FINANCIARE MERR?

- PARA fillimit të veprimtarisë — Kompensimi i Udhëtimit dhe Akomodimit**

Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit jepet **PARA** fillimit të veprimtarisë ndërkombëtare, në mënyrë që kandidati të mos ketë nevojë të parapaguajë shuma të mëdha. Për llogaritjen e këtyre vlerave, programi zbaton metodologjinë e Programit Erasmus+ të Bashkimit Europian një standard i provuar dhe i njohur ndërkombëtarisht.

Shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje llogariten mbi bazën e distancës ajrore në kilometra nga vendi i nisjes deri në vendin ku zhvillohet veprimtaria. Sa më e gjatë distanca, aq më e lartë vlera e kompensimit e ndarë në gjashtë fashë kilometrike. Vlerat e sakta financiare për secilën fashë janë përcaktuar në Lidhjen 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (si më poshtë).

Lidhja 1

VLERA E KOMPENSIMIT TË UDHËTIMIT SIPAS DISTANCËS	
Distanca në km	Vlera e kompensimit
100 — 499	22 000 lekë
500 — 1999	31 000 lekë
2000 — 2999	40 000 lekë
3000 — 3999	57 000 lekë
4000 — 7999	115 000 lekë
mbi 8000 km	170 000 lekë

Shpenzimet e akomodimit llogariten sipas numrit të netëve të qëndrimit dhe shtetit ku zhvillohet veprimtaria. Vendet janë të grupuara sipas nivelit të kostos së jetesës, gjithashtu në përputhje me praktikën e Erasmus+, dhe vlera për natë ndryshon sipas grupit të shtetit. Vlerat e plota për secilin shtet gjenden në Lidhjen 2 të të njëjtit vendim (si më poshtë).

VLERA E KOMPENSIMIT TË AKOMODIMIT SIPAS GRUP-SHTETEVE

Grup-shtetet	Vlera e kompensimit për natë qëndrimi
Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Islanda, Irlanda, Itali, Lihtenshtejn, Luksemburg, Holanda, Norvegjia, Suedia, Andorra, Monako, San Marino, Vatikan, Ishujt Faroe, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Australia, Zelanda e Re, Bahrejn, Kuvajt, Oman, Katar, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Brunei, Hong Kong, Japoni, Korea e Jugut, Makao, Singapor, Tajvan.	6 000 lekë

Armenia, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjeorgjia, Moldavia, Ukraina, Algjeria, Egjipt, Izrael, Jordania, Liban, Libia, Marok, Palestina, Siria, Tunizi, Rusia, Bangladesh, Butan, Kamboxhia, Kina, Korea e Veriut, Indi, Indonezi, Laos, Malajzia, Maldive, Mongolia, Mianmar, Nepali, Pakistan, Filipine, Sri Lanka, Tajlanda, Vietnam Afganistani, Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Turkmenistan, Uzbekistan, Iran, Irak, Jemen, Ishujt Kuk, Ishujt Fixhi, Kiribati, Ishujt Marshall, Mikronezia, Nauru, Niue, Palau, Papua Guinea e Re, Samoa, Ishujt Solomon, Timori Lindor, Tonga, Tuvalu, Vanuatu Angola, Benin, Botsvana, Burkina Faso, Burundi, Kamerun, Kepi i Gjellbër, Afrika Qendrore, Çad, Komoros, Kongo, Kongo Demokratike, Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Guinea Ekuatoriale, Eritrea, Esatini, Etiopia, Gabon, Gambia, Gana, Guinea, Guinea Bisau, Kenia, Lesoto, Liberia, Madagaskar, Malavia, Mali, Mauritania, Mauricius, Mozambik, Namibia, Niger, Nigeria, Ruanda, Sao Tome dhe Principe, Senegal, Sejshell, Sierra Leone, Somalia, Afrika e Jugut, Sudani i Jugut, Sudan, Tanzania, Togo, Uganda, Zambia, Zimbabve, Argjentina, Bolivia, Brazil, Kili, Kolumbia, Kosta Rika, Ekuadori, Salvador, Guatemala, Honduras, Meksika, Nikaragua, Panama, Paraguaj, Peru, Uruguaj, Venezuela, Antigua dhe Barbuda, Bahamas, Barbados, Belize, Kuba, Dominika, Republika Domenikane, Greanda, Guajana, Haiti, Xhamajka, Shën Kits dhe Nevis, Shën Lucia, Shën Vinsent dhe Grenadinet, Surinam, Trinidad dhe Tabago.	5000 lekë
Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Lituania, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Serbia, Turqi, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi.	4000 lekë

- **PAS veprimtarisë — Shpërblimi Financiar në bazë të arritjes**

Ky shpërblim jepet **PAS** veprimtarisë, nëse ke arritur rezultate të larta. Vlen vetëm nëse nuk merr shpërblim nga program tjetër shtetëror sipas Lidhjes 3 (si më poshtë).

Kujdes!! Duhet dorëzuar bashkë me dokumentet plotësuese shkresa apo vetëdeklarimi që nuk ke përfutur shpërblim tjetër.

Lidhja 3

KLASIFIKIMI NË VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE DHE SHPËRBLIMET		
a. KLASIFIKIMI NË RENDITJE INDIVIDUALE		
Veprimtari botërore	vendi i parë	60 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i dytë	40 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i tretë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i parë	50 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i dytë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i tretë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i parë	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i dytë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i tretë	10 000 lekë
b. KLASIFIKIMI NË RENDITJE EKIPORE		
Veprimtari botërore	vendi i parë	50 000 lekë

Veprimtari botërore	vendi i dytë	40 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i tretë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i parë	40 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i dytë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i tretë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i parë	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i dytë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i tretë	10 000 lekë
c. KLASIFIKIMI NË VEPRIMTARI INDIVIDUALE		
Veprimtari botërore	një nga çmimet e para	50 000 lekë
Veprimtari evropiane	një nga çmimet e para	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	një nga çmimet e para	20 000 lekë
ç. KLASIFIKIMI NË VEPRIMTARI EKIPORE		
Veprimtari botërore	një nga çmimet e para	50 000 lekë
Veprimtari evropiane	një nga çmimet e para	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	një nga çmimet e para	20 000 lekë

SI TË APLIKOSH?

Procesi Hap pas Hapi

1	Kontrollo thirrjen aktuale Shko në faqen zyrtare të AKR-së dhe gjej thirrjen vjetore aktive për Talentet Rinore. Thirrja qëndron e hapur gjatë gjithë vitit deri në përfundimin e buxhetit për programin e talenteve për vitin 2026.
2	Plotëso formularin e aplikimit Plotëso të dhënat për: veten tënde, veprimtarinë ndërkombëtare, organizatorin, mënyrën e përzgjedhjes, shpenzimet dhe personin shoqërues (nëse nevojitet).
3	Dorëzo dokumentacionin Dorëzo dokumentet e kërkuara (shih listën më poshtë). Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer nga përkthyes zyrtar.
4	Dorëzo aplikimin brenda afatit Për kompensim shpenzimesh - jo më vonë se 30 ditë PARA fillimit të veprimtarisë. Për shpërblim financiar - deri 45 ditë PAS përfundimit të veprimtarisë. Formulari i aplikimit (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohet në 2 (dy) kopje fizike (një origjinale ose e njehsuar me origjinalin dhe një kopje e thjeshtë), në adresën: Agjencia Kombëtare e Rinisë, Rruga “Naim Frashëri”, Nr. 37, Tiranë, Shqipëri.
5	Komisioni vlerëson aplikimin tënd

	Brenda 7 ditësh kalendarike, Komisioni i Vlerësimit kontrollon dokumentacionin dhe të njofton vendimin nëpërmjet e-mailit.
6	Nënshkruaj marrëveshjen me AKR-në Nëse aplikimi pranohet, nënshkruaj marrëveshjen me AKR-në. Paratë transferohen në llogarinë tënde bankare (ose të personit shoqërues sipas përcaktimeve të VKM-së) brenda 14 ditëve.
7	Dorëzo dokumentet justifikuese Pas përfundimit të veprimtarisë, dorëzo pranë AKR-së formularin e raportimit (sipas formatit përkatës online) dhe dokumentat justifikuese brenda 14 ditëve sic përcaktohet në pikën 23 të Seksionit III, të VKM-së.

DOKUMENTET JUSTIFIKUESE PËR T'U DORËZUAR

Dokumentet për Kompensimin e Shpenzimeve (Para Veprimtarisë)

- Ftesa e pjesëmarrjes, e lëshuar nga organizatorët e veprimtarisë ndërkombëtare.
- Dokumenti nga organizatorët ku tregohet çfarë shpenzimesh mbulojnë ata (ose konfirmim se nuk mbulojnë asgjë).
- Nëse je në olimpiadë shkollore: akti i miratimit nga Ministria e Arsimit (me konfirmim financiar).
- Nëse je sportist: akti i miratimit nga Komiteti Olimpik ose federata sportive (me konfirmim financiar).
- Vërtetim i mandatit të përfaqësimit në rastin e delegatit zyrtar.
- Nëse përfaqëson Shqipërinë jashtë vendit: dokumenti nga ambasada/konsullata shqiptare (me konfirmim financiar), sipas përcaktimeve të seksionit II, pika 3/d të VKM-së Nr.120, datë 27.02.2026.
- Nëse i përket kategorive me prioritet: dokumenti që vërteton statusin (dokumenti nga institucioni përgjegjës sipas rastit)
- Nëse ke nevojë për person shoqërues si PAK: Vendimi i komisionit mjekësor. *Gjithashtu kërkohet raporti mjeko-ligjor i personit shoqërues dhe vetedeklarimi për marrjen përsipër të detyrimeve sipas përcatimeve të seksioni III, pika 6 të VKM-së Nr.120, datë 27.02.2026.*
- Deklarata noteriale nga prindërit/kujdestari ligjor e noterizuar për personat nën 18 vjeç.

Dokumentet për Shpërblimin Financiar (Pas Veprimtarisë)

- Çmimi, certifikata ose dokumenti zyrtar nga organizatorët që vërteton rezultatin e arritur.
- Vërtetim ose vetedeklarim që nuk je duke përfituar shpërblim për të njëjtin rezultat nga program tjetër shtetëror.

Sa kompensim merr personi shoqërues?

	Kompensimi
1 deri në 2 fëmijë	50% e vlerës të kandidatit
3 ose më shumë fëmijë (grup)	150% e vlerës për një kandidat (kufi maksimal)
Kandidat nga kategoria prioritare ose PAK me person shoqërues personal	100% e vlerës të kandidatit

RREGULLAT E RËNDËSISHME DHE AFATET

Afatet Kyçe

	Jo më vonë se 30 ditë para veprimtarisë - dorëzo aplikimin për kompensim udhëtimi/akomodimi. <i>Përjashtim: Do të pranohet aplikimi i dorëzuar përtej afatit të përcaktuar, kur, për shkak të kushteve dhe të afateve të zhvillimit të veprimtarisë ndërkombëtare, respektimi i këtij afati nga kandidati nuk do të ishte i mundur.</i>
	Jo më vonë se 45 ditë pas veprimtarisë - dorëzo aplikimin për shpërblim financiar. <i>Përjashtim: Do të pranohet aplikimi i dorëzuar përtej afatit të përcaktuar kur, për shkak të kushteve dhe të afateve të zhvillimit të veprimtarisë ndërkombëtare, respektimi i këtij afati nga kandidati nuk do të ishte i mundur.</i>
	14 ditë pas veprimtarisë - dorëzo dokumentet justifikuese të udhëtimit dhe akomodimit pranë AKR-së.
	14 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes - paratë transferohen në llogarinë tënde bankare.

Ç'NDODH NËSE NUK RESPEKTON RREGULLAT?

Detyrimi i Kthimit të Fondeve nga Kandidati

Nëse pa shkaqe të arsyeshme:

- nuk paraqitesh në veprimtarinë ndërkombëtare,
- përjashtohesh nga veprimtaria ndërkombëtare,
- nuk e përfundon veprimtarinë ndërkombëtare, ose
- nuk dorëzon pranë AKR-së dokumentet justifikuese të udhëtimit e të akomodimit.

Detyrimi i Kthimit të Fondeve nga personi shoqërues

Nëse pa shkaqe të arsyeshme:

- kandidati ose personi shoqërues nuk paraqiten në veprimtarinë ndërkombëtare;
- kandidati përfitues përjashtohet nga veprimtaria ndërkombëtare;
- kandidati përfitues nuk e përfundon veprimtarinë ndërkombëtare; ose
- nuk dorëzon pranë AKR-së dokumentet justifikuese të udhëtimit e të akomodimit.

Kujdes!! Në bazë të VKM Nr. 120, datë 27.02.2026 si shkaqe të arsyeshme do të konsiderohen: *sëmundje të menjëhershme apo ndërrim jete të personit apo një anëtar të familjes së tij, fatkeqësi natyrore, anulime dhe vonesa të mjeteve të transportit, nuk varen nga personi, të vërtetuara sipas dokumentit përkatës.*

A mund të ankoresh?

- Po! Nëse Komisioni refuzon aplikimin ose nuk bie dakord me vlerën e kompensimit.
- Ankesa i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të AKR-së. Zbatohen rregullat e përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative.

PYETJE TË SHPESHTA

A mund të aplikoj dy herë në të njëjtin vit?

Normalisht jo. Ke të drejtë vetëm 1 herë gjatë një thirrje vjetore.

Përjashtimisht: nëse nga veprimtaria ku morët mbështetje fitoni të drejtën të kaloni në një veprimtari tjetër të një niveli më të lartë (p.sh. nga european në botëror) ti mund të aplikosh sërish për atë veprimtari të re, duke iu nënshtruar të njëjtat rregulla si një aplikim i ri.

Çfarë ndodh nëse shpenzimet e mia mbulohen nga organizatori?

Nëse organizatori mbulon të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, programi nuk të jep kompensim. Nëse mbulohen vetëm pjesërisht, programi kompenson diferencën.

A mund të aplikoj edhe nëse jem nga diaspora shqiptare?

Po, nëse ke shtetësinë shqiptare dhe je i përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë ose trashëgiminë kulturore/arsimore/shkencore/teknologjike ose sportive shqiptare, **me konfirmim nga ambasada shqiptare.**

Kujdes!! Kërkohet patjetër shtetësia shqiptare

Si bëhet aplikimi?

Deri sa sistemi elektronik i AKR-së të jetë plotësisht funksional, aplikimet do të dërgohen fizikisht pranë AKR-së, sipas instruksioneve në thirrje.

Nëse komisioni konstaton mungesë në dokumentacionin e dorëzuar?

Komisioni të njofton nëpërmjet e-mailit dhe të lë 7 ditë kalendarike për plotësimin e mungesave. Nëse nuk plotëson mangësitë brenda afatit të caktuar, aplikimi refuzohet automatikisht.

Është e rëndësishme të vini në aplikimin tuaj një numër telefoni dhe një adresë emaili funksionale.

Çfarë ndodh nëse nuk e përfundoj veprimtarinë apo nuk dorëzoj dokumentet?

Nëse pa arsye të justifikueshme nuk paraqitesh në veprimtari, përjashtohesh, nuk e përfundon veprimtarinë, ose nuk dorëzon dokumentet justifikuese, sipas ligjit ke detyrimin të kthesh të gjithë mbështetjen financiare të përfituar.

Si arsye të justifikueshme pranohen: *sëmundje të menjëhershme apo ndërrim jete të personit apo një anëtar të familjes së tij, fatkeqësi natyrore, anulime dhe vonesa të mjeteve të transportit, nuk varen nga personi, të vërtetuara sipas dokumentit përkatës*

A mund të ankojem nëse aplikimi im refuzohet?

Po, ke të drejtë ankese nëse Komisioni refuzon aplikimin tënd ose nuk bie dakord me vlerën e kompensimit. Ankesa drejtohet pranë Drejtorit të Përgjithëm të AKR-së dhe procedura ndjek rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.

A mund të aplikoj edhe nëse jam nga diaspora shqiptare?

Po, nëse je shtetas shqiptar. Shtetësia shqiptare është kusht i detyrueshëm në çdo rast.

Nëse plotëson këtë kusht dhe je përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë ose trashëgiminë e saj kulturore, arsimore, shkencore, teknologjike apo sportive në një veprimtari ndërkombëtare, mund të aplikosh. Në këtë rast aplikimi shoqërohet me një dokument konfirmimi nga misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë në vendin ku banon, i cili vërteton lidhjen tënde me komunitetin shqiptar dhe natyrën e përfaqësimit.

Kur kam të drejtë për person shoqërues dhe sa merr ai?

Ke të drejtë për person shoqërues nëse je fëmijë (nën 18 vjeç) ose person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmës personal. Për detajet e kompensimit, shiko seksionin "*Informacion për Personin Shoqërues*" në Udhëzues.

Si e di nëse i përkas një kategorie me prioritet dhe çfarë përfitoj shtesë?

Kategoritë me prioritet dhe përfitimet shtesë që vijnë me to janë të listuara në seksionin "Kategori me Përparësi" në Udhëzues. Nëse i përket njërës prej tyre, sigurohu të ngarkosh në aplikim dokumentin që vërteton statusin tënd.

LISTA E FORMULARËVE QË DUHET TË DORËZOHEN PËR APLIKIM

- A- Formulari i Aplikimit
- B- Formulari i Raportimit
- C- Vetëdeklarim që nuk kanë përfituar shpërblim nga një program tjetër.